

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Raport Muaj Tetor 2020

Informacion bazë

Administrimi i Fondit

Monedha
Vlera fillestare e kuotës
Shuma fillestare minimale
Shuma minimale pasuese

Komision në hyrje
Komision në dalje
Penalite ne rast terheqje te
parakohshme

Komision Administrimi ne vit
Kosto per transferte fondesh
nga pale te treta

Shoqëria
Raiffeisen Invest

sh.a

LEK

1,000

1,000

1,000

**Sipas rregullores
se AMF-se**

0%

0%

1.50%
**Referojuni
informacionit ne
deget e RBAL**



Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Fondi i Pensionit Vullnetar është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata për vitet pas largimit përfundimtar nga puna. Ky fond zotërohet bashkërisht nga anëtarët e fondit dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit.


Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe rrezikut të marrë përsipër.

Fondi synon të ndërtojë një portofol të përbëre kryesisht nga tituj borxhi te emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturim afatgjatë (me maturim më të lartë se një vit).

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi është në kategorinë e parë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit, pra në kategorinë me rrezik më të ulet.


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes së luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës se fondit. Të dhënët historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31.10.2020

Vlera Neto e Aseteve	855,311,659
Numri i investitoreve	3,106
Cmimi i Kuotes	1,873.9893
*Kthimi vjetor nga investimi (31.10.2019 - 31.10.2020)	4.42%

*Komisioni i administrimit zbritet përpala llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit te investimeve ne 31 Totor 2020



Ne kuader te politikes se investimit te fondit te Pensionit, investimet do te kryhen kryesisht ne bono thesari dhe obligacione, te emetuara ne tregun primar, duke patur parasysh qe aktiviteti i tregtimit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria shqiptare ne treg sekondar eshte i kufizuar.

Instrumenti

Ne % te Aseteve te Fondit

Obligacione Thesari	99.75%
Depozita / Llogari rrjedhese	0.25%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here ne muaj; Obligacionet 2 vjeçare nje here ne muaj; 7 dhe 10 vjeçare jane me te rralla, afersisht nje here ne tre muaj. Qeveria organizon ankande te obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuence nje here ne 2 muaj per secilin maturitet. Strategjia e investimeve vazhdon te jete e fokusuar ne investime afatgjate.

Vlera neto e aseteve te fondit eshte rreth LEK 855 milione ne date 31 Totor 2020.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Totor

Situata e krijuar nga pandemia globale per shkak te virusit COVID-19 nuk ka patur ndikim ne performancen e Fondit te Pensionit gjate muajit Totor. Asetet e Fondit janet te investuara vetem ne tituj te emetuar nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e tyre te interesit.

Pergjate muajit Totor ne tregun vendas normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare per gjithesht paten një rritje te lehte. Norma e obligacionit 2 vjeçar dhe e obligacionit 10 vjeçar u rrit ne krahesim me ankandet e fundit. Nderkohe qe norma e bonos se thesarit 12 mujore ra shume pak ne krahesim me muajin e kaluar.


Yield-i mesatar i ponderuar ne ankandin primar per Bono Thesari 12-mujore rezultoi ne 1.727%, duke rene me 0.01% krahesuar me normen e vendosur ne ankandin e fundit muajit Shtator qe ishte 1.74%.

Persa i perket ankandeve te obligacioneve, u zhvillua ankandi i obligacionit 2 vjeçar-i i emetuar ne LEK dhe rezultoi ne 2.40%, duke u rritur me 0.02% ne krahesim me ankandin e muajit Shtator;

Gjithashtu u zhvillua dhe ankandi i obligacionit 10 vjeçar dhe rezultoi ne 5.34% duke u rritur me 0.12% ne krahesim me ankandin e fundit qe ishte organizuar ne Korrik.

Rritjen me te larte e pesoi yieldi i obligacionit reference 3-vjeçar i emetuar ne LEK, i cili rezultoi ne 2.615%, duke u rritur me 0.18% ne yield krahesuar me ankandin e fundit qe ishte organizuar ne Gusht.

Grafiku me poshte jep një pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Totor 2019 – Totor 2020. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yields fiks te perllogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Totor.



Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 31 Totor 2020


Çmimi i kuotes se Fondit te Pensionit ka ndjekur një trend rrites dhe vlera e kuotes eshte rritur me 0.12% gjate muajit Totor.

Kthimi vjetor neto i fondit eshte 4.42% per periudhen 31 Totor 2019 – 31 Totor 2020;

Ai eshte me i ulet karahasuar me vitet e meparshme sepse edhe normat e interesit te titujve te Qeverise, ne te cilat fondi investon, kane qene ne renie gjate viteve te fundit.


Kthimi i fondit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondit te Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Ne dt 31 Totor 2020	1 Vit	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (31 Dhjetor 2010)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	4.42%	4.97%	5.63%	5.80%	6.59%

Kthimi vjetor historik per cdo vit i Fondit te Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Anetaret e fondit te Pensionit keshillohen te kene një horizont sa me te gjate qendrimi ne fond (mundesisht deri ne moshen e pensionit, pese vjet para moshes se percaktuar ne Ligj) per te perfituar një kthim maksimal nga investimi, per te permiresuar standartin e jetesës ne moshen e pensionit dhe per te evituar penalitetet ne rast terheqje te parakohshme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuan janë vetëm illustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, janë perdorur per qellime illustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit.

Raiffeisen Invest dhe forca shitese e fondit nuk garantojne një kthim te caktuar te fondit.

Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha, në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.